



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës.

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300562/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandime për garantimin e respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, si dhe për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/ Komisaratin e Policisë Kukës.*

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË KUKËS  
KUKËS

KOMISARIATIT TË POLICISË KUKËS  
KUKËS

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, si dhe duke vlerësuar angazhimin tuaj dhe të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi që institucioni i Avokatit të Popullit, zhvilloi në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Kukës.

Inspektimi në ambientet e privimit të lirisë në mjediset e këtij komisarati, u zhvillua nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Inspektimi u krye në datë 16.06.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë të Shtetit, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i

ndryshuar, procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”* miratuar me Urdhër nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, procedurën standarde të punës *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”* miratuar me Urdhër nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të tyre.

Në këtë kuadër, ekspertët e MKPT-së inspektuan ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në lidhje me plotësimin e kushteve materiale dhe infrastrukturore për jetesë normale të personave të privuar nga liria, zhvilluan intervistë me personin që ndodhej në dhomat e sigurisë, inspektuan zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, si dhe verifikuan zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm<sup>1</sup>.

Vizita inspektuese ishte e pa palajmëruar dhe u zhvillua pa mbikqyrjen e punonjësve të policisë gjatë kohës së zhvillimit të intervistës me personin që ndodhej në mjediset e policisë, në momentin e inspektimit.

Gjatë inspektimit, grupit të monitorimit iu krijuan kushte pune dhe një bashkëpunim i frytshëm nga drejtuesit dhe punonjësit e policisë në DVP dhe Komisariatin e Policisë Kukës, me qëllim arritjen e objektivave të inspektimit në përputhje me metodologjinë e MKPT-së për inspektimin e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Grupi i inspektimit të MKPT-së, në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit për institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e privuar nga liria, zhvilloi takim me ish- Drejtorin e DVP Kukës z.Arben Dashi, i cili u vu në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Drejtuesit në drejtorinë dhe komisariatin e policisë në Kukës, informuan grupin në lidhje me respektimin e të drejtave të personave që shoqërohen, ndalohen apo arrestohen në flagrancë, gjatë kohës të qëndrimit në mjediset e komisarariatit të policisë, si dhe plotësimin e kushteve infrastrukturore për trajtimin në mënyrë njerëzore dhe dinjitoze të këtyre personave, sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i inspektimit vizitoi dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, si dhe kontrollloi dhe administroi kopje të dokumentacionit e

---

<sup>1</sup> Shkresë nr.K4/I70-2 prot., datë 25.11.2022, dërgohet raporti me rekomandime për Drejtorinë dhe Komisariatin e Policisë Kukës.

regjistrave ku pasqyrohen veprimet e kryera me persona, nga momenti i hyrjes në mjediset e komisariatit.

U verifikua zbatimi i rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, ku rezultoi se, **nuk ishte zbatuar asnjë nga rekomandimet e mëposhtme:**

1. Nuk ishte krijuar një dhomë e veçantë për shoqërimin e të miturit në konflikt me ligjin, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.
2. Nuk ishte krijuar një zyrë për marrjen në pyetje të të shoqëruarve (të arrestuar në flagrancë) që dyshohen për kryerjen e veprave penale, para se të kalojnë në dhomat e sigurisë.
3. Nuk ishin instaluar kamera në dhomën e marrjes në pyetje apo intervistimin e të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore ose prokurorët e çështjes, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryhen me këta persona<sup>2</sup>.
4. Nuk ishte krijuar në ambientin e sigurisë një dhomë e veçantë, që të shërbejë si ambient ajrimi për personat e arrestuar/ndaluar<sup>3</sup>.

Nga informacioni i zv/drejtorit për policimin në komunitet në DVP Kukës dhe shefi i rendit në komisariatit e policisë Kukës, arsyeja e mos plotësimit të këtyre rekomandimeve ka qenë mungesa e fondeve buxhetore në zërin investime. Në informacionet dërguar DPPSH, DVP Kukës ka kërkuar rritjen e fondeve për investime (midis të cilave plotësimin e këtyre rekomandimeve), por dhe për vitin 2023, nuk është miratuar asnjë fond shtesë për investime në këtë drejtori<sup>4</sup>.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatit e Policisë Kukës ambienti i shoqërimit, është pjesërisht i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambienti i shoqërimit ndodhet në godinë më vehte nga godina kryesore e drejtorisë dhe komisariatit të policisë. Në këtë mjedis ndodhen 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara më vehte 1(një) për personat e rritur dhe 1(një) dhomë shoqërimi për gra. Në këtë ambient mungon një dhomë shoqërimi, e cila do të bënte të mundur ndarjen e personave të shoqëruar sipas përcaktimeve në kreu VII, pikën 4/b të procedurës standarde, ku thuhet

---

<sup>2</sup> Kreu XIV, pika 6.2/b 6 e procedurës standarde ku thuhet se: “Pajisjet e sigurisë audio - vizive vendosen në ambientet e mëposhtme: b) Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit”.

<sup>3</sup> Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde ku thuhet se: “Ajrimi kryhet në mjediset e caktuara brenda sistemit të ambienteve të dhomave të sigurisë, në një vend të ndërtuar posaçërisht (dhomat e ajrimit)”.

<sup>4</sup> Shkresë nr.374 prot., datë 20.09.2022 informacion për nevojat dhe kërkesat për buxhetin e vitit 2023.

shprehimisht se: “Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur”<sup>5</sup>.

Dhomat e shoqërimit ishin në gjendje të mirë teknike, me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme (përmasat 3mx4m), si dhe dritare që lejonin hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale. Ato ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, me një tavolinë pune për specialistët/ndihmës specialistët e policisë dhe 4(katër) karrige për qëndrimin ulur të të shoqëruarve, të cilat ishin të fiksuara në dysheme dhe të palëvizshme. Kapaciteti fizik për secilën dhomë shoqërimi, ishte për qëndrimin ulur të 4 deri 5 personave.

Koridori dhe dhomat e shoqërimit, kanë ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje të energjisë elektrike, siguronin ndriçimin nga gjeneratori që shërbente si burim alternative.

Në ambientin e shoqërimit, ndodhet dhoma për njohjen e personit e përbërë nga dy dhoma që ndahen në mes me xham pasqyrë, e cila përdoret nga oficerët e policisë gjyqësore për identifikimin dhe njohjen e personit, në rastet kur ai dyshohet për kryerjen e një vepre penale.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit, ndodhen dy tualete të ndara më vehte për meshkuj dhe për femra, të cilat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, të pajisura me nyje hidrosanitare. Ambienti furnizohej me ujë pandërprerje gjatë 24 orëve nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit të Kukësit.

Në ambientin e shoqërimit nuk ka dhomë më vehte për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohet në procedurën standarde, të plotësuar me pajisjet e orenditë e punës për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si tavolina e karrige, si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të palëvizshme<sup>6</sup>. Në mungesë të dhomës, procedura e intervistimit apo e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Ky fakt, është tepër shqetësues në lidhje me parandalimin e ushtrimit të forcës fizike apo psikologjike ndaj qytetarëve ndërsa merren në pyetje.

Dhomat e shoqërimit dhe ambientet ndihmëse që ndodheshin në këtë mjedis, ishin të lyera, të dizifektuara dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Koridori i ambientit të shoqërimit monitorohej nga 2 kamera, ndërsa në dhoma ishin instaluar nga një kamer, të cilat shërbenin për mbajtjen në vëzhgim të këtyre ambienteve. Sistemi i kamerave administrohej nga salla operative në DVP Kukës, ndërsa pamjet filmike ruheshin deri në 30 ditë.

---

<sup>5</sup> Kreu VII, pika 1,2 dhe 4 të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>6</sup> Kreu VII, pika 4/d e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Në ambientin jashtë dhomave të shoqërimit dhe brenda tyre, ishin të afishuara posterat me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit. Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, karta e të drejtave të shtetasve të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, duhet të vendosen brenda dhomave që ata të kenë mundësi aksesit efektiv, për njohjen me të drejtat e tyre në mjediset e Policisë së Shtetit.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person në cilësinë e të shoqëruarit, sipas përcaktimit në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar për periudhën Janar – Qershor 2023, ishin shoqëruar në këto mjedise 99 persona, nga të cilët vetëm 1(një) grua.

Në ambientin e shoqërimit dhe zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk u konstatuan sende apo mjete që të ekspozonin dhunë psikologjike te personat e shoqëruar, gjatë marrjes në pyetje nga specialistët apo ndihmës specialistët e policisë.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Ambienti i sigurisë në Komisariatin e Policisë Kukës, është i ndërtuar pjesërisht sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhër nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit<sup>7</sup>.

Ambienti i sigurisë ka 6 (gjashtë) dhoma sigurie, të cilat ndahen në 4 (katër) dhoma për personat arrestuar/ndaluar të rritur, 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë është për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e 8 (tetë) personave të ndaluar/arrestuar. Në dhomat e sigurisë të këtij komisarati, mbahen dhe personat e arrestuar apo të ndaluar nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Has. Nisur nga numri i veprave penale të kryera dhe numri i shtretërve, dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë në Kukës kanë kapacitete të mjaftueshme për mbajtjen dhe sigurimin e personave të arrestuar/të ndaluar nga të dy komisaritet e policisë Kukës dhe Has.

Dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara sipas normave dhe parametrave të përcaktuara në procedurën standarde, të ndara në dhomë dhe paradhomë, me një skarë hekuri dhe derë në mes të saj. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave plotësonin normat dhe parametrat teknik jetësorë për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më

---

<sup>7</sup> Kreu XIV, pika 6/b e Procedurës Standarde ku përcaktohet se: “**Pajisjet e sigurisë audio - vizive vendosen në ambientet e më poshtme:** b) Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit.”

pak se 10 m<sup>2</sup>, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>8</sup>

Dhoma për fjetje ishte e pajisur me krevatin me elementë hekuri (dy nga dhomat kishin 2 krevatë), një WC e fiksuar në mënyrë të pa çmontueshme pa depozitën e ujit, si dhe buton zile/sinjali e montuar në mur, për kontakt me punonjësin e shërbimit në rast nevojë. Ato ishin gjithashtu të kompletuara me dyshekë, batanie dhe jastëk për fjetje. Ndërsa në paradhomë, ishin të vendosura dhe të instaluar pajisjet për mbajtjen e higjienës personale si lavaman me rubinetin e ujit, depozitë uji për WC-në, pajisje elektrike si çelës dhe llampa për ndriçim të përshtatshëm të paradhomës e dhomës së qëndrimit, si dhe një pajisje për ngrohje qëndrore gjatë dimrit.

Në kohën e inspektimit në dhomat e sigurisë ndodhej vetëm një person, i cili ishte në moshë madhore dhe në cilësinë e të arrestuarit. Koha e qëndrimit në ambientin e sigurisë, ishte brenda afatit 96 orë të përcaktuar Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa, për periudhën Janar - Qershor 2023, në regjistër u evidentuan të rregjistruar 45 persona të ndaluar/arrestuar, nga të cilët 15 shtetas të huaj. Nga verifikimi i këtij regjistri, në periudha të ndryshme kohore, nuk u evidentuan raste të mbipopullimit në dhomat e sigurisë.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Gjithashtu, dhomat kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Ambienti i sigurisë ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjieno-sanitare.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej:

- i) zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë;
- ii) dhoma për marrjen në pyetje të të arrestuarve nga përfaqësuesi i organit të akuzës dhe për takime me avokatin mbrojtës; si dhe,
- iii) dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore.

Në korridor ndodhej dhe një aparat telefoni fiks, për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, mbahen nën administrim rregjistrat për evidentimin e të dhënave dhe aktivitetin që zhvillohen me personat e ndaluar/arrestuar, sikurse përcaktohen në procedurën standard. Konkretisht; i) regjistri për evidentimin e personave të arrestuar/ndaluar; ii) regjistri i sendeve personale; iii) regjistri i marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore; iv) regjistri i takimeve me mbrojtësit ligjorë (avokatë e kujdestarë), mbrojtësit e të drejtave të njeriut Avokatin e Popullit, OJF etj.; v) regjistri i evidentimit të vizitës mjeksore që kryhet menjëherë pas arrestimit/ndalimit dhe vizitat mjeksore që kryhen në qendrat spitalore; vi) regjistri i

---

<sup>8</sup> *Kreu VII, pika 3.3 e procedurës standarte "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

kërkesë/ankesave, etj. Te gjithë regjistrat ishin të sekretuar me vulë nga sekretaria e institucionit.

Dhoma e marrjes në pyetje të personave të arrestuar ishte e pajisur me karrige për qëndrimin ulur dhe tavolinë pune, të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizëshme. Punonjësit e policisë gjyqësore apo prokurori, prezantoheshin para se të kryenin veprimet procedurale me personat e arrestuar apo të ndaluar. Kjo dhomë **nuk** është e pajisur me sistemin e kamerave audio – vizive, për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore që kryhen me të arrestuarit/ndaluarit<sup>9</sup>. Ky ambient shërbente njëkohësisht edhe si dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët mbrojtës, të cilat realizoheshin sa herë kërkohej nga ana e tyre.

Gjithashtu, dhoma e mjekut është e pajisur me orenditë dhe pajisjet e nevojshme, si tavolinë pune e mjekut e fiksuar në dysheme në mënyrë të palëvizëshme, karrige pune, një kasafortë e mbyllur me çelës për mbajtjen e medikamenteve mjeksore dhe të dokumentacionit për shërbimin mjekësor, si dhe krevat për kryerjen e vizitave e kontrolleve mjeksore me të arrestuarit/ ndaluarit. Dhoma është e pajisur me sistem për ngrohje. Për secilin person të arrestuar apo të ndaluar hapet kartela mjeksore, e cila plotësohet nga ndihmësmjeku në organikë të DVP Kukës.

Dhomat e sigurisë dhe dhomat e punës të stafit të policisë, ishin të e pastra nga ana higjieno-sanitare, me ajrosje dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial (elektrik). Ambienti dhe dhomat e sigurisë ngrohen me kalorifer, nëpërmjet sistemit të kaldajave në periudhën e dimrit. Në fundin e korridorit në ambientin e sigurisë, ndodhet një ambient i përbashkët tualeti dhe dushi me ujë të ngrohtë (me bolier), që shërben për larjen e trupit sipas nevojave që paraqesin personat e ndaluar/arrestuar.

Hyrja e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitorohen nga 2 kamera përgjatë 24 orëve, pamjet e të cilave ruhen deri në 30 ditë. Mbajtja në vëzhgim e ambienteve kryhej nga salla operative e DVP Kukës, ndërsa pamjet filmike administrohen nga specialisti i IT në organikën e kësaj drejtorie.

Në rastet, kur personat e ndaluar/arrestuar ishin shtetas të huaj, zbatoheshin procedura e njoftimit të përfaqësive diplomatike të vendit të tyre, si dhe pajiseshin me kartën e të drejtave në gjuhën e tyre amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë. Punonjësit e policisë, asistojnë shtetasit e huaj për sigurimin e avokatit mbrojtës dhe të një përkthyesi në gjuhën e tyre. Në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, ndodhej letra me të drejtat e shtetasve të ndaluar/arrestuar që ju privohet liria në mjediset e policisë, e cila ishte e përkthyer në 10 gjuhë të huaja kryesore.

## **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

---

<sup>9</sup> *Kreu XIV, pika 6.1 dhe 6.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*

Në ambientin e shoqërimit të komisariatit, ndodhej “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, i cili ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019. Procedura e shoqërimit të shtetasve, realizohej sipas kërkesave të parashikuara në nenet 109 dhe 122/1, të ligjit “Për policinë e shtetit” dhe regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Regjistri për personat e shoqëruar ishte i sekretuar dhe administrohej nga ndihmës specialisti për informacionin në këtë komisarit. Nga këqyrja e regjistrit, u konstatua se në tërësi rubrikat e regjistrit ishin të plotësuara në rregull, me përjashtim të rubrikës të njoftimit të familjarëve të të shoqëruarit. Në këtë rubrikë, duhet të pasqyrohen të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vend ndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit, sikurse përcaktohet në procedurën standarde<sup>10</sup>. Por, nga verifikimi i regjistrit rezultoi se, punonjësi i informacionit shënonte vetëm “njoftuar familja”, pa vendosur emrin e familjarit, numrin e telefonit dhe orën e njoftimit. Ky konstatim, përbën shkelje të kërkesave të parashikuara në procedurën standarde nga punonjësit e informacionit dhe njëkohësisht mohim i të drejtës për informim të personave të shoqëruar.

Koha e qëndrimit në ambientin e shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri 4 orë, por jo më shumë se 10 orë. Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryhet nga oficeri/agjenti i policisë gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295.2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit nën hetim, shkonte deri në 12 orë.

Personat e ndaluar/arrestuar ishin të evidentuar në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Të dhënat në regjistër ishin të hedhura dhe të plotësuara me korrektësi sipas të gjitha rubrikave të tij.

Nga verifikimi i fashikujve ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve, të kryera nga punonjësit e komisariateve të policisë në varësi të DVP Kukës, u konstatua se zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit, për ndryshimin e praktikës së viteteve të kaluara lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë apo ndalimit, orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës. Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

---

<sup>10</sup> *Kreu VII, pika a.1.2 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*



Në lidhje me zgjidhjen e kërkesë/ankesat e personave që shoqërohen, arrestohen apo ndalohen në mjediset e komisariatit, ato evidentohen në regjistrin përkatës të të shoqëruarve, por dhe në proces-verbalin e shoqërimit që firmoset në përfundim të procedurave nga specialisti i policisë dhe personi i shoqëruar, kopjen e të cilit ata e marrin me vehte. Por, nisur nga përcaktimi në procedurën standarde se, personat e shoqëruar kanë të drejtë të paraqesin kërkesa apo ankesa për mënyrën e shoqërimit, mbajtjes, trajtimit dhe respektimit të të drejtave nga personeli policor gjatë shoqërimit dhe mbajtjes në ambientet e policisë, është detyrim mbajtja e një regjistri në zyrën e informacionit të komisariatit për evidentimin e trajtimit dhe zgjidhjes së tyre. Kjo dhe për faktin tjetër se, proces verbali i shoqërimit ku shënohen pretendimet e të shoqëruarit në lidhje me respektimin e të drejtave në mjediset e policisë, është një dokument që merret me vehte nga i shoqëruari dhe kopja tjetër qëndron në sekretari/arshivën e organit të policisë.

Lidhur me mungesën e regjistrit për evidentimin e kërkesë/ankesave, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar në vijëmbësi organeve vendore të policisë së shtetit, vendosjen e këtij regjistri në zyrën e informacionit, ku të pasqyrohen të gjitha llojet e kërkesë/ankesave të të shoqëruarve dhe mënyra e zgjidhjes së tyre nga punonjësit e policisë. Ky regjistër garanton në praktikë njohjen me të drejtat ligjore të të shoqëruarve që nga fillimi i privimit të lirisë kur hyn në mjediset e komisariatit, si dhe i informon ata mbi të drejtën që gëzojnë këta persona për të bërë kërkesa apo ankesa për mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së tyre nga punonjësit e policisë apo në rastin më të keq, pretendimeve për ushtrim dhune dhe keqtrajtim nga punonjësit e policisë.

Në zyrën e informacionit ndodhej një regjistër i veçantë për evidentimin e të dhënave për personat e mitur, ndërsa mungonte si regjistër në dhomat e sigurisë. Detyrimi për hapjen më vehte të regjistrit për të miturit, është i parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, si dhe në rekomandimin e Avokatit të Popullit për këtë qëllim.

### **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë**

Në momentin e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës, ndodhej vetëm një person në dhomat e sigurisë në cilësinë e personit të arrestuar. Nga intervista që zhvilloi grupi i inspektimit me këtë person, nuk u konstatuan ankesa apo pretendime në lidhje me keqtrajtimin apo përdorimin e forcës tej kufijve të lejuar, nga punonjësit e policisë gjatë kohës të shoqërimit për në mjediset e komisariatit dhe qëndrimit të tij në dhomat e sigurisë.

U evidentua nga inspektimi se, personat e ndaluar/arrestuar, trajtohen me ushqim tre herë në ditë (të miturit katër herë në ditë), sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej në kuzhinën e përbashkët me IEVP Kukës, e cila ndodhet brenda territorit të komisariatit të policisë Kukës.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulturi, nga intervista me punonjësit e policisë, u evidentua se të ndaluarit/arrestuarit që dëshironin, u lejohej të predikonin ritet fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarit/arrestuarit furnizoheshin rregullisht me produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Kjo u verifikua dhe në intervistën e zhvilluar me personin e arrestuar që ndodhej në dhomat e sigurisë.

Nga kqyrja e regjistrit, koha e qëndrimit të personave në dhomat e sigurisë, ishte brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, deri në 96 orë, për vleftësimin e masës së sigurisë nga gjykata. Personat e ndaluar, për të cilët gjykata ka lëshuar vendim të formës së prerë “arrest me burg”, transferoheshin menjëherë në ambientet e I EVP Kukës, që ndodhej në të njëjtën godinë me dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës.

### **Ambientet e intervistimit**

Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës, ka një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët. Ajo ishte e pajisur me orëditë e nevojshme si karrige dhe tavolinë të fiksuara në dysheme të palëvizëshme, por siç e theksuam dhe më lart, kjo dhomë **nuk** është e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive.

Ndërsa, në ambientin e shoqërimit, mungon një dhomë e veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të arrestuar në flagrancë apo të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, para se ata të kalojnë në dhomat e sigurisë. Në të gjitha rastet, personat e shoqëruar merren në pyetje/intervistohen në zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilat **nuk** janë në vëzhgim dhe monitorim të kamerave, gjatë kryerjes të veprimeve procedurale me këta persona.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre<sup>11</sup>.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit janë të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut i cili ishte në organikë të DVP Kukës. Intervistimi i të miturve, kryhej në ambient të veçantë i krijuar me donacion të UNICEF dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar në bashkëpunim me DPSH-në, në

---

<sup>11</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

kuadër të Programit “*Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qënieve njerëzore në dhe nga Shqipëria*” 2019-2022. Ky ambient ishte i kompletuar me orenditë e nevojshme si tavolina pune dhe kompjuter për punonjësit e policisë, si dhe karrige e kolltuqe për qëndrimin ulur të fëmijës, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës. Punonjësit e policisë që trajtonin rastet e të miturve në konflikt me ligjin, ishin strukturë më vehte dhe të trajnuar për këtë qëllim.

Në Komisarlatin e Policisë Kukës ishte krijuar një dhomë (magazinë) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, deri në përfundim të hetimit nga organi i akuzës.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Gjatë inspektimit, u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Kukës, janë të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar.

Për shtetasit e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar, punonjësit e policisë që kryenin veprime proceduriale, jepej letra me të drejtat e tyre që në momentin e privimit të lirisë, kur hyjnë në mjediset e komisarlatit të policisë. Për shtetasit e huaj, letra me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve është e përkthyer në 10 gjuhë të huaja si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht, rome dhe në gjuhën arabe.

Sipas informacionit të punonjësve të policisë, personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruarit, njiheshin që në fillim të veprimeve proceduriale nga punonjësit e policisë, me të drejtën për të patur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje nga punonjësit e policisë. Në rast se kërkohej prej tyre, u krijohej menjëherë mundësia për të kontaktuar me të. Kur personat e ndaluar/arrestuar, nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, ju sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht. Avokatët mbrojtës siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre.

Personave të ndaluar dhe arrestuar, në momentin kur ju komunikohet masa e “arrestit me burg”, pajiseshin me setin e dokumenteve nga oficerët e policisë gjyqësore si, kopje të proces-verbalit të ndalimit/arrestimit, kopje të kontrollit dhe sendeve personale, si dhe kopja e letrës me të drejtat e tyre. Një gjë e tillë u verifikua nga dokumentet që dispononte personi që ndodhej në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit.

Personave të shoqëruar në mjediset e policisë u jepej karta me të drejtat e tyre, që në momentin e hyrjes në komisarlatin e policisë. Në përfundim të kohës së shoqërimit, këtyre personave iu jepej gjithashtu edhe kopje e proces-verbalit të shoqërimit, ku shënohej koha dhe arsyet e shoqërimit, si dhe pretendimet e të shoqëruarit për mënyrën e trajtimit nga punonjësit e policisë.

Vizitat mjekësore e personave të ndaluar/arrestuar, kryhej nga ndihmësmjeku në organikë të DVP Kukës, brenda afatit 12 orë nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi*”

*i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*".<sup>12</sup>

Ndihmësmjeku kishte të pasqyruar në regjistrin e vizitave mjekësore, kryerjen e vizitës mjekësore për secilin të ndaluar/arrestuar, gjendjen shëndetësore të tyre, si dhe rekomandimet për medikamentet që duhet të marrë gjatë ditëve të qëndrimit në dhomat e sigurisë. Në dosjet me fashikull të çdo të ndaluar/arrestuari, e cila administrohej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, ndodhej dhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) për secilin prej tyre.

Në ambientin e sigurisë, ishte e afishuar lista e personave të miratuar që kanë të drejtë të hyjnë në këtë ambient, lista e avokatëve mbrojtës, si dhe ishte afishuar numri i kontaktit me zyrën e Avokatit të Popullit.

Në këtë komisariat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika 1/f të procedurave standarde "*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit*", për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*";

### **REKOMANDOJMË:**

1. Të merren masa të menjëhershme, për krijimin në ambientin e shoqërimit të një dhome shoqërimi për të miturit në konflikt me ligjin, e cila të jetë e ndarë më vehte nga dhomat e shoqërimit për personat e rritur dhe për gra, sikurse përcaktohet në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në procedurën standarde: "*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*".
2. Të merren masat e nevojshme, për krijimin në ambientin e shoqërimit të një dhome për marrjen në pyetje të të shoqëruarve (të arrestuar në flagrancë), para se të kalojnë në dhomat e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me video dhe audio në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin e të ndaluar/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore, që ndodhet në ambientet e sigurisë të këtij komisariati<sup>13</sup>.

<sup>12</sup> *Kreu II, pika 7.2 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*.

<sup>13</sup> *Kreu XIV, pika 6.2/b 6 e procedurës standarde ku thuhet se: "Pajisjet e sigurisë audio - vizive vendosen në ambientet e më poshtme: b) Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për të*

3. Të merren masa të menjëhershme, për vendosjen në ambientin e shoqërimit të një regjistri për evidentimin e mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes të kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar.
4. Të merren masa të menjëhershme, për vendosjen në dhomat e sigurisë të një regjistri të veçantë për evidentimin e të dhënave për të miturit në konflikt me ligjin.
5. Të organizohen trajnime me punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit dhe dhomat e sigurisë, në lidhje me plotësimin korrekt të librave dhe regjistrave sipas rubrikave, kryesisht njoftimin e familjarëve të personave që ndodhen në ambientet e privimit të lirisë, sipas kërkesave të parashikuara në aktet ligjore dhe rekomandimet e CPT-së, për këtë qëllim.
6. Në ambientin e sigurisë të krijohet një dhomë e veçantë, që të shërbejë si ambient ajrimi për personat e arrestuar/ndaluar<sup>14</sup>.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**

---

regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit”.

<sup>14</sup> Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde ku thuhet se: “Ajrimi kryhet në mjedise të caktuara brenda sistemit të ambienteve të dhomave të sigurisë, në një vend të ndërtuar posaçërisht (dhomat e ajrimit)”.